



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

U R D H Ë R Nr. 261 Datë 17. 09. 2004

PËR
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TË PROKURORIT NE LETËRPOROSITË PËR JASHTË
SHTETIT

Me synim,

- për të garantuar ushtrimin e funksioneve të prokurorit në leterporositë për jashtë shtetit;
- për të përmirësuar nivelin cilësorë të kërkesëve dhe për te unifikuar praktikën në ushtrimin e këtyre funksioneve në Prokuroritë e te gjitha niveleve, si dhe;

Mbështetur, në aktet ndërkombëtare të ratifikuara, në nenet 24 pika 4, 509 e vijues të K. Pr. Penale dhe në nenin 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr, 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J :

1. Kur gjatë ushtrimit të ndjekjes penale evidentohet nevoja për ndihmë juridike nga autoritetet e një shteti të huaj, drejtuesi i Prokurorisë që ka në ndjekje procedimin penal ose prokurori i caktuar prej tij, në mbështetje të Konventës së Këshillit të Evropës "Për ndihmën e ndërsjellët juridike në fushën penale" dhe Protokolleve të parë e të dytë shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8498¹ datë 10. 06. 1999 dhe me ligjin Nr. 8883² datë 18. 04. 2002, si dhe të nenit 509 e vijues të K, Pr. Penale, i dërgon Ministrisë së Drejtësisë, kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë nga autoritetet gjyqësore të shtetit të huaj.

2, Kërkesa duhet të përmbajë³:

- 2.1 emrin e Prokurorisë që bën kërkesën dhe emrin e autoritetit gjyqësor të shtetit të huaj;
- 2.2 objektin dhe arsyen e kërkesës;
- 2.3 nëse është e mundur, identitetin dhe kombësinë e personit në Çështje;
- 2.4 nëse është e mundur, emrin dhe adresën e personit që kërkohet ekzekutimi i letërporosisë;
- 2.5 relacion mbi llojin e veprës penale dhe një paraqitje të përmbledhure fakteve;

¹ Shih fletoren zyrtare nr. 21 viti 19

² Shih fletoren zyrtare nr. 17 dhe nr 17/1 te vitit 2002

³ Shih, nenin 14 të Konventës "Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushen penale"

2.6 në vartësi të llojit të kërkesës, çdo informacion tjetër specifik, që parashikohet në aktet ndërkombëtare të përmendura më sipër.

3. Në raste të ngutshme⁴, kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, drejtuesi i Prokurorisë, menjëherë, mund t'ja dërgojë autoriteteve gjyqësore të huaja, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë të kësaj Zyre.

3.1 Në këto raste, drejtuesi i Prokurorisë kompetente ose Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë e kësaj Zyre, menjëherë, duhet të informojnë Ministrinë e Drejtësisë.

4. Kopja e kërkesës për letërporosinë dhe e akteve përkatëse duhet të dorëzohet, menjëherë, në Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë të kësaj Zyre, e cila bashkërendon me institucionet e tjera brenda e jashtë vendit dhe ndjek në dinamikë realizimin në afat të kërkesës nga autoritetet gjyqësore të huaja.

5. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë e kësaj Zyre, të ndihmojë nga ana metodike, të ndjek dhe mbikëqyr Prokuroritë e shkallës së parë, për plotësimin korrekt dhe në afat të kërkesave në këtë fushë.

5.1. Kjo drejtori, të përcaktojë dhe të përgatisë modele për lloje të akteve që duhet të formulohen sipas kërkesave që disponon prokurori ose drejtuesi i Prokurorisë në këtë fushë, si dhe ja dërgojë për zbatim Prokurorive të shkallës së parë, deri me datë 15. 10. 2004.

6. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve dhe strukturat e kësaj zyre.

7. Mospërbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

8. Me këtë urdhër të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të gjithë niveleve.

9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

⁴ Shih po aty neni 15 dhe 509/5 i K.Pr.Penale